



Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë

Lagja e Spitalit nr.3, Prishtinë, Kosovë 10000

Tel. +381(0) 38 512-392

<http://www.lhp-ks.org>

Nr. _____ prot.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA	
INSTITUTI I HISTORISË - INSTITUTE OF HISTORY - INSTITUT ZA ISTORIJU	
Nr. e Org. Org. Unit Orgjeti	Nr. i prot. Prot. N Br. 9701
Nr. Farjeve No. Përveç Br. Straume	Dati: Date: Datum:
01/21/2016 09/11/2016	
PRISHTINË - A	

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Sheshi "Fan Noli" Tirana, Shqipëri

Tel. ++ 355 (0) 4 223 03 05

<http://www.akad.gov.al>

Nr. _____ prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Palët pajtohen për bashkëpunim të ndërsjellë

Neni 1

Palët

1. Palët në këtë marrëveshje janë:

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Shqipëri) dhe Institut i Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë (Kosovë)

Neni 2

Qëllimi dhe arsyetimi

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje është që të përcaktojë fushëveprimin e bashkëpunimit të palëve, për realizimin e interesave të dyanshme në fushën kërkimore-shkencore dhe akademike.
2. Palët pajtohen duke detaujar qëllimin e Marrëveshjes nga pikë 1 dhe pikat në vijim.
3. Përfitues të këtij bashkëpunimi janë studiuesit e të dyja institacioneve, palë të Marrëveshjes.

Neni 3

Fushëveprimi i bashkëpunimit të palëve

1. Palët pajtohen që të bashkëpunojnë për punë të përbashkëta kërkimore-shkencore dhe akademike.
2. Palët do të bashkëpunojnë për organizimin e veprimitarive shkencore në interes të dy institacioneve si: konferenca dhe simpoziume të përbashkëta për ngjarje dhe personalitete historike, në botime të përbashkëta nga fusha e historiografisë, në botimin e studimeve dhe artikujve shkencor në revistat shkencore
3. Palët pajtohen që të këmbejnë materialet arkivore dhe literaturë shkencore.
4. Palët do të shkëmbejnë të gjitha botimet e realizuara
5. Palët do të ofrojnë ndihmë të ndërsjellë për studiuesit për të lehtësuar punën në kryerjen e veprimitarisë kërkimore-shkencore.
6. Palët do të pajtohen për këmbimin e kuadrove shkencore, sipas nevojës dhe kërkesave të dy institacioneve.
7. Pjesëmarrjen e studiuesve në projekte të përbashkëta të dy institacioneve respektive.
8. Palët pajtohen që përveç pikave të lartshënuara (1-10), të bashkëpunojnë edhe në çështje të tjera, të cilat do t'i rregullojnë me marrëveshje të veçanta.

9. Marrëveshja mund të plotësohet dhe ndryshohet sipas nevojës së të dy palëve.

Neni 4
Autorizimet

1. Palët garantojnë që bashkëpunimi të realizohet në pajtim me këtë Marrëveshje.
2. Asnjëra nga palët nuk ngarkohet me obligime të veçanta, përveç atyre që përcaktohen në këtë Marrëveshje.

Neni 5
Anulimi

1. Anulimi i kësaj Marrëveshje mund të bëhet me vullnetin e palëve, në rast se njëra prej tyre ka dështuar ta përbushë atë.
2. Pala që dëshiron anulimin është e obliguar që të njoftojë palën tjeter të paktën një muaj përpara.

Neni 6
Gjuha

1. Gjuhët e përdorura në këtë Marrëveshje është gjuha shqipe.

Neni 7
Kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Marrëveshja është e vlefshme për një periudhë të pacaktuar, për aq kohë sa nuk kërkohet nga asnjëra prej palëve


Neni 8
Numri i kopjeve

1. Ky Memorandum është hartuar në 2 (dy) kopje, nga një për secilën palë nënshkruese.

PALËT NËNSHKRUUESE

Drejtori
Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë

Prof. asoc. dr. Sabit SYLA



Kryetari
Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Akademik Muzafer KORKUTI



Tiranë 25.10.2016